



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 dhjetor 2016
Nr. ref.:RK1022/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI55/16

Parashtrues

Slobodan Radović

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 2/2016, të 12 janarit 2016

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Slobodan Radović nga Mitrovica (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Firma e Avokatëve Judex nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 2/2016, të 12 janarit 2016. Aktvendimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar atij më 16 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartcekur, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat nga neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], neni 24.2 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 mars 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 prill 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 1 gusht 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 15 nëntor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga 23 qershor 2003 deri më 22 shtator 2005, parashtruesi i kërkesës kishte punuar si polic në Shërbimin Policor të Kosovës. Më 22 shtator 2005, ai dha dorëheqje në vendin e tij të punës.
10. Më 14 mars 2015, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Policinë e Kosovës (në tekstin e mëtejme: PK) për t'u rikthyer në pozitën e tij të mëparshme.
11. Pasi parashtruesi nuk mori asnjë përgjigje nga PK-ja, ai parashtrroi kërkesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: MPB), që të rikthehet në pozitën e tij të mëparshme. Parashtruesi i kërkesës prapë nuk mori asnjë përgjigje.

12. Më 19 qershor 2014, pas heshtjes administrative të PK-së dhe MPB-së, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi civile në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, me të cilën kërkoi që pikat 7 dhe 8 të “Marrëveshjes së Brukselit” (*Marrëveshja e parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë nga 2013*) të respektohen dhe që ai të rikthehet në vendin e tij të mëparshëm.
13. Më 27 nëntor 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës, sepse sipas Ligjit për të Drejtat Themelore nga marrëdhënia e punës dhe Ligjit të punës nr. 3/L-212, padia ishte parashtruar jashtë afatit.
14. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Themelore theksoi:

“[...] se me dispozitat ligjore përcaktohet që një punëtor i cili nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të organit kompetent në organizatë ose nëse autoriteti nuk nxjerr vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës apo ankesës, ka të drejtë që brenda 15 ditëve të kërkon mbrojtjen e të drejtave të tij para gjykatës kompetente. Padiësi nuk e ka bërë atë”
15. Në afatin ligjor, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër vendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 9 tetor 2015, Gjykata e Apelit, me Vendimin Ac. nr. 132/2015, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin: *“Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e vërtetoi gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se padia është jashtë afatit dhe në vendimin e kontestuar dha arsye të mjaftueshme ligjore dhe faktike dhe faktet relevante të rëndësishme për zgjidhjen e këtij rasti ...”*
17. Në afatin ligjor, parashtruesi parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.
18. Më 12 janar 2016, Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr. 2/2016, e refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion, si të pabazuar, duke theksuar se *“...sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme aktvendimi i kontestuar nuk përmban të meta që mund të kontestojnë drejtësinë e tij në lidhje me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, si dhe gjykata e shkallës së parë dhe kjo gjykatë konstatojnë se padia e padiësit është jashtë afatit, pasi që padiësi nuk ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës brenda afatit të parashikuar në nenin 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës ... Gjithashtu, edhe në bazë të neneve 78 dhe 79 të Ligjit për Punë të Kosovës padia e padiësit është e parakohshme”*.

Ligji relevant (*Ligji i punës nr. 03/L-212*)

Neni 78 Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit

1. *I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.*

2. *Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.*

[...]

Neni 79 Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi e bazon kërkesën e tij në faktin se gjykatat nuk e kanë zbatuar drejt Marrëveshjen e Brukselit si *lex specialis* në lidhje me themelimin e marrëdhënies së punës së tij.
20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “[...] Pas vendimeve gjyqësore i është pamundësuar kthimi në vendin e punës duke ia mohuar të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit dhe me këto vendime gjykatat gjithashtu kanë bërë shkelje të nenit 19 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
21. Parashtruesi kërkon nga Gjykata ta deklaron kërkesën të pranueshme; të konkludon se ka pasur shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës; se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNj).

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata gjithashtu i referohet edhe nenit 48, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe i cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

25. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

26. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e disa neneve të Kushtetutës, duke i lidhur ato me refuzimin e padisë së tij nga gjykatat e rregullta, e cila kishte të bënte me kthimin në vendin e punës.

27. Në këtë rast, Gjykata vëren që gjykatat e rregullta e refuzuan kërkesëpadinë e parashtruesit për shkaqe thjesht formale, sepse ishte e paraqitur jashtë afatit kohor dhe nuk ishte dorëzuar siç është përcaktuar me nenet përkatëse të Ligjit të punës (nenet 78 dhe 79), dhe rrjedhimisht, gjykatat nuk e kanë trajtuar vet esencën e kërkesës së parashtruesit.

28. Gjykata nxjerr në pah praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), sipas së cilës detyra e Gjykatës nuk është të rishikojë konkludimet e gjykatave të rregullta lidhur me gjendjen faktike dhe zbatimin e ligjit (shih, GJEDNJ, *Pronina kundër Rusisë*, Vendimi për pranueshmërinë, të 30 qershorit 2005, parashtrës nr. 65167/01), as të zëvendëson gjykatat e rregullta në vlerësimin e fakteve dhe provave. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të shqyrtojë nëse ka pasur shkelje të mundshme të të drejtave kushtetuese në procedurat e mbajtura para gjykatave të rregullta.

29. Gjykata rikujton se sipas jurisprudencës së GJEDNJ, drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës në tërësi (GJEDNJ, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, seria A, numër 146, paragrafi 68), dhe bazuar në këtë, Gjykata gjatë vlerësimit të meritave kushtetuese të pretendimeve të parashtruesit mbështetet në praktikën e GJEDNJ-së, si dhe në praktikën e vendosur të kësaj Gjykate.

30. Në këtë drejtim, Gjykata më tej vëren se parashtruesi konsideron që gjykatat e rregullta ia kanë shkel të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

31. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me vendimin nuk është e mjaftueshme për të ngritur një kërkesë të besueshme për shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë. Kur pretendohen shkelje kushtetuese, parashtruesi duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të padiskutueshme për të mbështetur pretendimet e tij, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (shih, Aktvendimi për papranueshmëri, të 30 qershorit 2014, nr. KI198/13, *Agjencia Kosovare e Privatizimit*).
32. Gjykata gjithashtu konsideron si të pabazuara pretendimet e parashtruesit në lidhje me shkelje të nenit 24.2 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, sepse procedurat e mbajtura dhe vendimet e marra me të cilat padia e parashtruesit hedhet poshtë si jashtë afatit, nuk janë mbajtur dhe vendosur në bazë të diskriminimit të përcaktuar në nenin 24.2 të Kushtetutës, por vetëm në bazë të rregullave përkatës ligjore, përkatësisht neneve 78 dhe 79 të Ligjit të punës.
33. Gjithashtu, Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja përcakton se diskriminimi “është trajtimi i ndryshëm, pa një qëllim objektiv dhe justifikim të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme” (shih, Aktgjykimi Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 36042/97, paragrafi 48, GJEDNJ, 2002-IV, Aktgjykimi Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë, paragrafi 63, D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke, paragrafi 44).
34. Gjykata, gjithashtu i konsideron si të pabazuara edhe pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, pasi ai nuk është viktimë e një veprimi ose aktit të autoritetit kompetent në lidhje me humbjen ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës, as nuk i është ndaluar me vendim të një organi për të punuar dhe për të kryer profesion për të cilin mendon se ka të drejtë, por ndërprerja e marrëdhënies së punës së tij përbën akt të vullnetit të tij personal për në kohë dhe rrethana të përcaktuara.
35. Si përfundim, Gjykata, duke u bazuar në të gjitha faktet e këtij rasti që rrjedhin nga dokumentet e paraqitura në Gjykatë dhe nga pretendimet ankimore të parashtruesit, konsideroi se gjykatat e rregullta kanë dhënë përgjigje dhe arsyetime të hollësishme në vendimet e tyre se pse padia e tij është refuzuar, si jashtë afatit, kështu që nuk mund të konkludohet se zbatimi i dispozitave përkatëse ligjore në çdo pjesë të procedurës para gjykatave të rregullta ishte arbitrar dhe as se zbatimi i së drejtës procedurale dhe garancive ishte në dëm të parashtruesit.
36. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, as ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

37. Prandaj, kërkesa në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 nëntor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Arta Rama-Hajrizi

